

MIRELA XHAFERRAJ (MITRO)

A KA JETUAR ARISTOFANI NË ANTIKITET PARA 2500 VJETËSH?

Përmbledhje

Mesazhet që përcillen nëpërmjet komedive të Aristofanit janë të shumta e shpesh herë tingëllojnë më se aktuale. Nëpërmjet përdorimit mjeshtëror të gjuhës dhe satirës ai arrin të skalisë personazhe e situata që nga njëra anë paraqesin realitetin social e politik të Athinës klasike, por nga ana tjetër duket sikur tingëllojnë të njohura edhe për një realitet tjetër, realitetin tonë. Çfarë cilësish duhet të ketë dikush që të merret me politikë? A ka vend femra në politikë? Si jepet drejtësia nga shërbëtorët e drejtësisë? Duket se këndvështrimi i Aristofanit për këto çështje nuk është shumë larg këndvështrimit të sotëm. A thua se ai ka jetuar (edhe) në një tjetër kohë.

Aristofani është përfaqësuesi kryesor i komedisë në letërsinë antike greke. Prej rreth 44 veprave të tij, sot kanë arritur të plota vetëm 11. Këto vepra karakterizohen nga një satirë tepër e fuqishme, e në disa raste therëse që u bëhet çështjeve të ndryshme të shoqërisë së Athinës së periudhës në të cilën jetoi (gjysma e dytë e shekullit të pestë dhe fillimet e shekullit të katërt p.e.s.), qoftë politike si tek *Kalorësit* apo *Aharnianët*, qoftë sociale si te “*Gratë në parlament*” apo tek *Retë*, por edhe të natyrës poetike (në kuptimin që Aristoteli e përdor këtë term) tek *Bretkosat*. Përveç çështjeve kryesore të cilat trajtohen te veprat e tij të shpëtuar, që lidhen me jetën politike e kulturore në shoqërinë athinase, hasim midis rreshtave fragmente e problematika të cilat tingëllojnë aktuale edhe sot. Disa pasazhe nga këto vepra duket sikur i referohen (edhe) një kohe tjetër.

Të bësh politikë

Te *Kalorësit*, e cila është një komedi politike, që konsiderohet një nga veprat më të mira të Aristofanit me të cilën ai fitoi çmimin e parë në vitin 424 p.K., Aristofani i kundërvihet demagogut Kleon, por edhe parlamentit të Athinës që e konsideron përgjegjës për gjendjen në të cilën është katandisur Demosi (populli), të cilin e paraqet në mënyrë alegorike si të zotin e shtëpisë, ndërsa politikanët si shërbëtorët e tij, duke i parë gjërat nga i njëjti këndvështrim me oratorët e shekullit të katërt, të cilët i përkasin lëvizjes politike demokratike të kohës¹. Por këto sulme të Aristofanit ndaj shoqërisë së kohës nuk janë sulme ndaj rendit demokratik, por kritika ndaj përfaqësuesve të

¹ K. Dover, *Η κωμωδία του Αριστοφάνη*, μτφρ.: Φ. Κακριδής, Μορφωτικό Ίδρυμα Εθνικής Τραπέζης, Αθήνα, 1978, f. 137/140.

padenjë të këtij rendi². Aristofani mendon se Demosi duhet të ushtronte pushtetin e dhënë me më shumë ndërgjegje dhe vigjilencë për të mos lejuar politikanët ta mashtrojnë duke mbushur xhepat e tyre dhe duke përndjekur kundërshtarët e tyre³, por në vazhdim Demosi shfaqet duke treguar se nuk është aq i mefshtë, por se qëllimisht i lë njerëzit që të vjedhin e pasurohen prej tij që në vazhdim drejtësia t'i bëjë të kthejnë mbrapsht gjithçka. Në këtë rast Aristofani nëpërmjet këtyre fjalëve të Demosit përpiket që të shmangë akuzën se po fyen pushtetin⁴.

Sa herë më vjedhin unë hiqem se nuk shoh asgjë, por jam vigjilent dhe më vonë i detyroj të vjellin ato që më kanë vjedhur duke u vendosur në fyt lakun e votimit gjyqësor (Kalorësit 1145 -1150)

Te *Kalorësit* Aristofani demaskon tipin e politikanit që karakterizohet nga mënyra lajkatare për t'iu drejtuar Demosit, gatishmëria për garantimin e ligjshmërisë dhe zelli i madh për të përndjekur personat me sjellje antipatriotike, tipin e politikanit që promovon masa ekonomike që sjellin përfitime afatshkurtra, por nuk sigurojnë zhvillimin afatgjatë të ekonomisë⁵. Çfarë cilësish duhet të ketë dikush që të merret me politikë? Dialogu ndërmjet Kukurecaxhiut dhe Demostenit na e jep një përgjigje:

Kukurecaxhiu: *Po, më thuaj, si do të bëhem një burrë i tillë kur unë veç nga sallamet marr vesh?*

Demosteni: *Pikërisht prandaj do bëhesh burrë i madh, sepse je tepër dinak, arrogant dhe njeri i pazareve (178 - 182)*

...Që të merret dikush me politikë, s'i duhet as shkolla dhe as edukata (191 -192)

Në një studim për nivelin e elitës politike në Shqipëri, përfundimet nuk janë aspak larg kritereve të Demostenit te *Kalorësit* e Aristofanit: *CV-të e deputetëve japin një ide të qartë të nivelit të tyre intelektual, po ti referohemi arsimimit që ata kanë. Shifrat janë zhgënjyese....*

Nëse një deputet që mund të konsiderohet figurë politike për një parti, do të kishte kualifikim profesional dhe arsimim të mirë, nuk do të ndodhte që një deputet të ngatërrojë fjalën asete me fjalën aksese. Kjo ka ndodhur në komision hetimor parlamentar për firmat piramidale...

... Nga 140 (deputetë) të Kuvendit, 45 prej tyre nuk përvetësojnë asnjë gjuhë të huaj⁶...

² Muzafer Xhaxhiu, *Letërsia antike greke*, Shblu, 1998, f. 208.

³ Po aty, f. 141.

⁴ Albin Lesky, *Ιστορία της αρχαίας ελληνικής λογοτεχνίας*, μτφρ.: Αγαπητού Τσοπανάκη, Εκδοτικός Οίκος Αδελφών Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη 1983.

⁵ K. Dover, *Η κωμωδία του Αριστοφάνη*, μτφρ.: Φ. Κακριδής, Μορφωτικό Ίδρυμα Εθνικής Τραπέζης, Αθήνα, 1978, f. 141-142.

⁶ *Elita politike në Shqipëri, arsimimi*, 28 janar, 2012, <http://studimepolitike.com/2012/01/28/elita-politike-ne-shqiperi-arsimimi/>

Demokracia e Athinës klasike, mbi modelin e së cilës u ndërtuan edhe demokracitë moderne, sigurisht që ka pësuar ndryshime, por me sa duket disa situata jo fort të këndshme në parlament nuk ndryshojnë shumë nga ato të sotmet. Mjafton të lexojmë disa vargje të komedisë së Aristofanit duke i krahasuar me disa rreshta marrë nga shtypi i sotëm:

Kleoni: *Mos mendo se mund të shash, i dashur,*

sikur të ishe në parlament. Shkojmë te Demosi. (Kalorësit, 722)

Sherri mes deputetëve në Kuvend: Do të marr shpirtin, legen⁷. (lapsi.al)

Edhe Aristofani, gjuha e të cilit karakterizohet shpesh nga përdorimi i fjalëve e shprehjeve liçencioze e të guximshme, s'do të mund ta kishte krijuar një varg të tillë. Dhe le të mos harrojmë se situatat e krijuara nga Aristofani janë shpesh të ekzagjeruara në funksion të humorit dhe satirës.

Gratë në parlament?!

Dy komeditë e Aristofanit *Gratë në parlament* dhe *Lisistrata* pasqyrojnë atë lëvizje të gjerë për të drejtat e grave që kishte filluar nga fundi i shekullit të V⁸. Praksagora te *Lisistrata*, janë dy personazhe femërorë që me mençurinë, shkathtësinë, këmbënguljen dhe forcën që i karakterizon arrijnë qëllimin e tyre që në të dyja rastet lidhet me shoqërinë athinase të kohës, por nga dy këndvështrime të ndryshme. Duket se gjendja ekonomike e politike e vendit për të ndryshuar kërkon që drejtësinë e shtetit ta marrin në dorë gratë te *Gratë në parlament*, sepse është e vetmja gjë që s'është provuar akoma në qytet. (*Gratë në parlament 455-457*), përderisa në demokracinë athinase gratë nuk e kishin të drejtën të merrnin pjesë në parlament dhe të bëheshin pjesë e vendimmarrjes. Por në fund Aristofani del në përfundimin se ndërtimi i një shoqërie ideale, ku të mbizotërojnë barazia, ku siç thotë edhe Praksagora të mos ketë: *As mashtrime, as urrejtje për fqinjët, / askush s'do të jetë i zhveshur dhe i varfër. / As do të shpifë dhe as lërë veten si garanci. (565 - 568) Do përcaktohet një mënyrë jetese e njëjtë dhe e përbashkët për të gjithë. (594)*, është thjesht një utopi⁹ dhe pjesa e fundit e komedisë *Gratë në parlament* përbën një karikaturë të kësaj utopie sociale, e cila u bë aktuale për letërsinë dhe lidhej me krizën e rendë shoqërore të shekullit të IV dhe diferencimin madh të klasave nga ana ekonomike¹⁰. Mosbesim ndaj aftësive të grave duket edhe te *Lisistrata* ku Probuli u drejtohet grave, kryesisht Lisistratës: *Po si do jini, moj, kaq të zonjat, / saqë t'u gjeni fundin ngatërresave / që ngjasin me shumicë në çdo vend? (564 - 566)*. I njëjti diskutim se nëse dhe sa duhet të

⁷ <http://www.lapsi.al/lajme/2015/03/16/sherri-mes-deputet%C3%ABve-n%C3%AB-kuvend-do-t%C3%AB-marr-shpirtin-legen>

⁸ Muzafer Xhaxhiu, *Letërsia antike greke*, Shblu, 1998, f. 204.

⁹ Αριστοφάνης, *Ιππής, Εκκλησιάζουσαι*, μτφρ.: Μιχαήλ Βασσάλος, Λάζαρος Βασσάλος, De Agostini, 2005.

¹⁰ Muzafer Xhaxhiu, *Letërsia antike greke*, Shblu, 1998, f. 205.

marrin pjesë gratë në qeverisje e në politikë bëhet edhe sot, kur shtrohet akoma pyetja: Ka vend femra në politikë? Tituj dhe fragmente shkëputur nga shtypi shqiptar e vërtetojnë më së miri këtë:

*Gratë shqiptare përfaqësohen nga një numër shumë i vogël grash në politikë e vendimmarrje*¹¹ (Tiranë, më 10 shkurt, 2015 – Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”)

*...Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Florian Raunig, theksoi nevojën për një rritje të dukshme të përfaqësimit të grave në politikën shqiptare, si një element kyç për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë*¹². (Gazeta Shekulli)

Pra ky perceptim nuk ka ndryshuar edhe pas kaq vitesh, edhe pas kaq lëvizjesh feministe, ligjesh e projektligjesh për kuota të caktuara të femrave në instancat vendimmarrëse.

Drejtësia e drejtësisë

Një tjetër çështje që Aristofani e paraqet nëpërmjet situatave komike dhe satirës është edhe ajo e gjykatave dhe mënyrën se si jepej drejtësia prej gjykatësve. Në agonin ndërmjet plakut gjyqtar Filokleon dhe të birit parashtrihen problematikat e sistemit të drejtësisë së kohës (535 -620), për të cilin të shumta kanë qenë akuzat për ryshfete, parregullsi dhe ndërhyrje politike¹³. është pikërisht kjo mënyrë e ushtrimit të pushtetit që i pëlqen Filokleonit, i cili e njehson pushtetin e vet me atë të Zeusit (629), kur njerëzit e lusin, e lajkatojnë, i kërkojnë mëshirë, por i biri i kundërvihet duke i treguar se kjo fuqi është thjesht një iluzion, të cilët i përdorin gjykatësit për t’u hakmarrë ndaj kundërshtarëve të tyre dhe njëkohësisht mbushin edhe xhepat¹⁴.

A nuk është ky një nga debatet që bëhet së fundmi edhe në vendin tonë?

*Këto janë pasojat e një sistemi drejtësie që nuk funksionon për shkak të paaftësisë dhe korrupsionit të llahtarshëm. Gjyqtarët bëjnë pazar me kriminelët*¹⁵..., shprehet ministri i brendshëm.

*Edhe pse problemi më i madh për sistemin e drejtësisë është korrupsioni, gjyqtarët nuk mendojnë kështu*¹⁶.

¹¹ <http://www.ajogaron.com/index.php/63-grate-shqiptare-perfaqesohen-nga-nje-numer-shume-i-vogel-grash-ne-politike-e-vendimmarrje>

¹² <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=225812>

¹³ K. Dover, *Η κωμωδία του Αριστοφάνη*, μτφρ.: Φ. Κακριδής, Μορφωτικό Ίδρυμα Εθνικής Τραπέζης, Αθήνα, 1978, f.184.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ <http://www.gazetatema.net/web/2015/01/18/tahiri-gjyqtaret-e-korruptuar-po-mbajne-vendin-ne-thundren-e-dhunes-e-kriminit/>

¹⁶ <http://www.gazetatema.net/web/2014/12/01/gjyqtaret-thone-se-problemi-me-i-madh-ne-drejtessi-eshtepolitika-korrupsionin-e-rendisin-te-fundit/>

*Në një sondazh të organizuar me 34% të gjyqtarëve të Shkallës së parë të të gjitha rretheve, ata kanë nxjerrë si problemin më të madh në drejtësi, ndërhyrjet politike*¹⁷.

Këto fragmente nga shtypi i sotëm tregojnë më së miri se ky debat akoma nuk ka përfunduar. Mund të hasen gjithmonë Filoklenë, të joshur nga pushteti që të jep dhënia drejtësisë, të korruptuar, apo të ndikuar nga politika, por ka gjithmonë edhe nga ata që do t'u kundërvihen.

Aristofani në veprat e tij trajton edhe tema të tjera që janë universale e të përhershme si lufta dhe paqja te *Aharnianët* apo *Paqja*, përfitimi dhe ndarja e pasurisë te *Pluti*, ku përpiqet të japë përsëri një zgjidhje utopike, por e kupton se ajo nuk mund të funksionojë, problematika që edhe për shumë kohë do të mbeten aktuale.

Vallë shoqëria ka ndryshuar aq pak që prej antikitetit, apo Aristofani përmes veprës së tij arriti të depërtonte në kohën ku jetoi dhe përtej saj, aq sa duket sikur është zhvendosur në kohë?

BIBLIOGRAFI

- Albin Lesky (1983), *Ιστορία της αρχαίας ελληνικής λογοτεχνίας*, μτφρ.: Αγαπητού Τσοπανάκη, Εκδοτικός Οίκος Αδελφών Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη.
- Francis MacDonald Cornford (1993), *Η αττική κωμωδία*, μτφρ.: Λ. Ζενάκος, Παπαδήμας Δημ. Ν.
- K. Dover (1978), *Η κωμωδία του Αριστοφάνη*, μτφρ.: Φ. Κακριδής, Μορφωτικό Ίδρυμα Εθνικής Τραπέζης, Αθήνα.
- Muzafer Xhaxhiu, *Letërsia antike greke*, Shblu, 1998.
- Sazan Goliku (2001-2002), *Kumte për pajtim dhe paqe nga letërsia e antikitetit*, Albanohellenica, 77-89.
- Αριστοφάνης (2005) *Ιππής, Εκκλησιάζουσai*, Μετάφραση Μιχαήλ Βασσάλος, Λάζαρος Βασσάλος, De Agostini.
- Αριστοφάνης (2005) *Λυσιστράτη*, Μετάφραση Μιχαήλ Βασσάλος, Νίκος Νικολίτσας, De Agostini.

Faqe internet për vjeljen e ilustrimeve

- <http://www.lapsi.al/lajme/2015/03/16/sherri-mes-deputet%C3%ABve-n%C3%AB-kuvend-do-t%C3%AB-marr-shpirtin-legen>
- <http://www.ajogaron.com/index.php/63-grate-shqiptare-perfaqesohen-nga-nje-numer-shume-i-vogel-grash-ne-politike-e-vendimmarrje>
- <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=225812>
- <http://www.gazetatema.net/web/2015/01/18/tahiri-gjyqtaret-e-korruptuar-po-mbajne-vendin-ne-thundren-e-dhunes-e-krimet/>
- <http://www.gazetatema.net/web/2014/12/01/gjyqtaret-thone-se-problemi-me-i-madh-ne-drejttesi-eshtepolitika-korrupsionin-e-rendisin-te-fundit/>
- <http://www.gazetatema.net/web/2014/12/01/gjyqtaret-thone-se-problemi-me-i-madh-ne-drejttesi-eshtepolitika-korrupsionin-e-rendisin-te-fundit/>
- <http://studimepolitike.com/2012/01/28/elita-politike-ne-shqiperi-arsimimi/>

¹⁷ <http://www.gazetatema.net/web/2014/12/01/gjyqtaret-thone-se-problemi-me-i-madh-ne-drejttesi-eshtepolitika-korrupsionin-e-rendisin-te-fundit/>

